



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal

01 Nr.020-17767/1

Dt.29.09.2014

Në bazë të nenit 10.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-072 , nenit 37.2(c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, konform Vendimit Nr.1679-2014 të Komisionit Qendror Zgjedhor të dt.13.08.2014, dhe betimit të dhënë të delegatit Ymridin Fetahu, në seancën e Kuvendi Komunal të Dragashit të dt.29.09.2014, miratohet ky:

V E N D I M

- I. **z.Ymridin Fetahu**, është delegat i ri i KK-së Dragash në vend të delegatit të mëparshëm Emin Kolloni, pas dorheqjes nga lista zgjedhore e të njejtit subjekt politikë (PDK-së).
- II. Zgjedhja zgjat deri në përfundimin e mandatit të përbërjes ekzistuese të Kuvendit Komunal-Dragash.
- III. Me rastin e zgjedhjes, të larpërmendurit i takojnë të gjitha të drejtat ligjore-materiale, si anëtarë-delegat i Kuvendit Komunal-Dragash.
- IV. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

I dërgohet:

- z. Ymridin Fetahu,
- Kryetarit të të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi,
- Zyrës së Personelit-Dragash, menaxherit Muhidin Emini,
- Drejtoratit për Financa, Ekonomi e Zhvillim, drejtorit Ahmet bahtijari,
- Zyrtarit të larstë Financiar të komunës-Dragash Beqir Rashiti, dhe
- Arkivit



Kryesuasi i KK-së Dragash

Shaban Shabani



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal

01 Nr.020-17767/2

Dt.29.09.2014

Në bazë të nenit 10.3 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-072 , nenit 37.2(c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, konform Vendimit Nr.1680 -2014 të Komisionit Qendror Zgjedhor të dt.13.08.2014, dhe betimit të dhënë të delegatit – Nevzat Hamza, në seancën e Kuvendi Komunal të Dragashit të dt.29.09.2014, miratohet ky:

V E N D I M

- I. **z.Nevzat Hamza**, është delegat i ri i KK-së Dragash në vend të delegatit të mëparshëm Adem Hoxha, pas dorheqjes nga lista zgjedhore e të njejtit subjekt politikë (CDU-së).
- II. Zgjedhja zgjat deri në përfundimin e mandatit të përbërjes ekzistuese të Kuvendit Komunal-Dragash.
- III. Me rastin e zgjedhjes, të larpërmendurit i takojnë të gjitha të drejtat ligjore-materiale, si anëtarë-delegat i Kuvendit Komunal-Dragash.
- IV. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

I dërgohet:

- z. Nevzat Hamza,
- Kryetarit të të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi,
- Zyrës së Personelit-Dragash, menaxherit Muhidin Emini,
- Drejtoratit për Financa, Ekonomi e Zhvillim, drejtorit Ahmet bahtijari,
- Zyrtarit të larstë Financiar të komunës-Dragash Beqir Rashiti, dhe
- Arkivit



Kryesuesi i KK-së Dragash,

Shaban Shabani



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal

01 Nr.020-17767/5

Dt.29.09.2014

Kuvendi Komunal i Dragashit, në sencën e dt.29.09.2014, në bazë të neneve 17 e 19.3 të Ligjit për Vetëqverisje Lokale dhe nenit 49.2 të Statutit të Komunës-Dragash, pas shqyrtimit paraprak të Vendimit 2014/69 të Kuvendit të Komunës Sapanca (Turqi), për vëllazërim, miraton këtë:

V E N D I M

- I. **PËRKRAHET** Vendimi i Kuvendit të Komunës së Sapanca nga Turqia për vëllazërim me Komunën e Dragashit (Republika e Kosovës).
- II. Për vëllazërim vendosën, unanimisht-27 delegatët, e Kuvendit Komunal të Dragashit.
- III. Vëllazërimi vlen për të gjitha fushat e jetës dhe punës, me interes të përbashkët e që do të vazhdohet me kontakte të drejtpërdrejta të delegacioneve të të dyjave komunave nga organet zyrtare komunale, si dhe subjekte tjera të interesuara.
- IV. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe do të njoftohet Komuna e Spanacës, për të vazhduar aktivitetet tjera zyrtare dhe të tjera në mes të dy komunave të vëllazëruara.

Arsyetim

Komuna e Sapanacës (Turqi) ka shprehur intersim për vëllazërim dhe bashkëpunim me Komunën e Dragashit (Kosovë), duke e zyrtarizuar këtë me Vendimin e saj 2014/69 të dt.02.09.2014, të cilin e përkrahi, pas njoftimit paraprak, edhe Kuvendi Komunal i Dragashit në seancën e dt.29.09.2014, duke vendosur si në pikat I e II të këtij Vendimi.

Vendimin e këtill Kuvendi Komunal i Dragashit e ndër morri nga fakti se, në të ardhmen, llogaritet se do të ketë interes të përbashkët të bashkëpunimit vëllazëror në të gjitha fushat e jetës dhe punës.

I dërgohet:

- z.Aydin Yilmazer, kryetar i Komunës Sapanca (Turqi),
- Kryetarit të të Komunës-Dragash z.Salim Jenuzi, dhe
- Arkivit



Kryesuesi i KK-së Dragash

Shaban Shabani



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

- **Kuvendi Komunal**
01 Nr.020-17767/6
Dt.29.09.2014
D r a g a s h

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 32.2 të Statutit të komunës-Dragash, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.29.09.2014, pas shqyrtimit paraprak të Propozimit të kryetarit të komunës-Dragash për miratimin urgjent të Vendimit për ndarjene trolit për ndërtim të shtëpisë për të këthyerin Nagip Mandak nga f.Brod-Dragash, konform lëndës 04 Nr.463-9/2013 të Drejtoratit për Urbanizëm, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(Shërbimi Pronësoro-Juridik) të komunës-Dragash, miraton këtë:

V E N D I M

- I. **I NDAHET**, për shfrytëzim-99 vjet, pa kompenzim, trolli z.Nagip Mandak nga Brodi komuna-Dragash, në sipërfaqe 110 m/2 në pjesën e parcelës kadastrale 2122-ZK Brod e cila evidentohet si "Shantinica-Shantinica" e që evidentohet në emër të komunës-Dragash, me qëllim të ndërtimit të shtëpisë për të këthyerin e larpërmendur.
- II. **OBLIGOHET** Drejtorati për Urbanizëm, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit (Shërbimi Pronësoro-Juridik) i komunës-Dragash, që në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi, të përfundon procedurën e nevojshme të kësaj lënde, duke lëshuar edhe Aktvendimin për ndarjen e trollit në fjalë.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

Arsyetim

Duke e pasur parasysh Propozimin e larpërmendur të kryetarit të komunës-Dragash konform lëndës 04 Nr.463-9/2013 të Drejtoratit për Urbanizëm, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit(Shërbimi Pronësoro-Juridik), Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.29.09.2014, vendosi si në pikën I të këtij Vendimi, duke pasur parasysh rastin specifik dhe urgjencën për zgjidhjen e çështjes së banimit të të këthyreit Nagip Mandak.

I dërgohet:

- Drejtoratit për Urbanizëm, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të komunës-Dragash,drejtorit Bean Haxhihasan,
- z.Nagip Mandak-Brod (Dragash), dhe
- Arkivit



Kryesuesi i KK-së
Shaban Shabani